



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:167374

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04857205

P.nr.49A/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit E.B. nga O..., i akuzuar për veprën penale Dhune në Familje neni 248 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.352/2023F të datës 04.08.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 17.10.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi, të dëmtuarës S.B. dhe i akuzuari E.B., me datë 20.10.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.10.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.B., i biri i N. dhe nëna M., e gjinisë T., i lindur me 01.06.1982, në O..., me vendbanim në fshati P...KK O..., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, Rom, Shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 18.05.2023, rreth orës 22:15, në fshatin P... në Komunën e O..., në N.K. dhe atë derisa e dëmtuara ishte mysafire tek vajza e saj K.B., i pandehuri E. me dashje dhe qëllim të cenimit të dinjitetit të dëmtuarës-bashkëshortes së tij me të cilën bashkëjeton, i njëjti ka ushtruar dhunë psikike dhe fizike ndaj saj, ashtu që ka shkuar në banesën e K. ku ishte S., pas fjalosjes me të ku i ka kërkuar asaj që të bëjë be në Kuran se nuk ka pasur marrëdhënie intime me mikun e tij B.H., pastaj e ka kapur për gjoksi me të dy duart dhe e ka shtyrë duke e rrëzuar në dysheme në skaj të një dysheku dhe atë në prezencë të dhëndrit D.B. dhe vajzave të S., K., V. dhe djalit të tyre M.B. të cilët kanë ndërhyrë për ti ndarë, me çka tek e dëmtuara ka shkaktuar shqetësim të madhe emocional, ankth, frikë dhe pasiguri për jetën e saj,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 46, 47,48, 69, 70, 71, 72 dhe 248 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- I. Për veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së të akuzuarit E.B., Gjykata i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 €uro të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën verifikuese prej një (1) viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- III. E dëmtuara S.B., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.352/2023F të datës 04.08.2023, ndaj të akuzuarit E.B. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 17.10.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Nazmi Krasniqi, të dëmtuarës S.B. dhe të akuzuarit E.B., ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, i ka kërkuar falje bashkëshortes, tani kemi rregulluar raportet mes veti dhe nuk kemi probleme të tilla.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nga i pandehuri pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike të përshkruar si në aktakuzë si dhe deklarimit të dëmtuarës se jemi pajtuar me bashkëshortin dhe kërkon nga Gjykata që mos të e dënojë të pandehurin pasi që është hera e parë që kemi ardhur para gjykatës për një gjë të tillë dhe kemi 20 vite bashkësi martesore.

Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, , si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2023-AJ-0154 i datës 18.05.2023; Raporti i Policisë S.H. #1555, i datës 19.05.2023; Shënimi zyrtar i zyrtarit policor S.H. #1555, i datës 19.05.2023; Raporti ditor i dhunës familjare, i datës 18.05.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarës/dëshmitares S.B., të datës 19.05.2023 dhënë në Stacionin Policor në O...; Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarit E.B, të datës 18.05.2023, dhënë në Stacioni Policor në O..., si dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit E.B. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Ndërsa si rrethanë rënduese ishte fakti se vepra penale ishte kryer brenda marrëdhënies familjare.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 48 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtit të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-se.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Gjykata në kuptim të nenit 462 par. 2 të KPRK-së, palën e dëmtuar e udhëzoi në kontest civil për realizimin e kërkesës së saj pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.49A/23 më datë 31.10.2023**

Bashkëpunëtori Profesional

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Albrim Kastrati

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.